



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 71-të, të mbajtur më 30.06.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-5396/1 të datës 27.11.2019 me pretendime kundër ----- . HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme kompetente për faktin se nuk përcaktohen pretendimet në lëndë.

Lënda me numër 12 -5396 të datës 13.10.2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Nga një parashtrues i panjohur, u dorëzua denoncim i regjistruar me numër 12-5396/1 të datës 27.11.2019, për keqpërdorim dhe konflikt të interesit -----.

Në denoncim theksohet se kompania -----është ndërmarrës i projektit - Rregullimi i një pjese të lumit Bregalnica, i cili është financuar nga SHA Ekonomia e Ujërave të RMV-së dhe firma e përmendur ishte mbajtës i licencës ----- nga 15.05.2019 dhe të njëjtën e ka lëshuar Ministria e Mjedisit Jetësorë dhe Planifikimit Hapësinor. Në denoncim theksohet se paraqitet personi si pronar formal -----e cila supozohet se është nëna e ----- , i cili sipas parashtruesit është pronar joformal i kompanisë dhe në të njëjtën kohë është punëtor në SHA Ekonomia e Ujërave të RMV-së nga viti 2018. Parashtruesi kërkon nga KSHPK-ja të përcaktojë nëse ka një konflikt interesi në dhënien e tenderit për rregullimin e një pjese të lumit Bregalnica të firmës së deklaruar, pasi sipas të dhënave personi ----- si pronar joformal i firmës është punonjës në SHA Ekonomia e Ujërave të RMV-së.

Në trajtimin e denoncimit në fjalë, KSHPK-ja realizoi kontroll në lidhje me regjistrimin e subjektit të denoncuar në Regjistrin Qendror të RMV-së dhe nga mbikëqyrja e bër në gjendjen e tij aktuale, KSHPK -ja konstatoi se personi i denoncuar -----nuk paraqitet si pronar ose udhëheqës.

Gjithashtu, në përputhje me rregullat ligjore pozitive, nuk ka asnjë ndalim që një kompani e një personi të afërt të punësuar nga SHA Ekonomia e Ujërave të RMV-së nuk mund të marrë pjesë në procedurat për dhënien e një tenderi për gjermimin e rërës.

Duke pasur parasysh të konstatuarën, KSHPK-ja përcaktoi se nuk vërtetohen pretendimet në lëndë, pas së cilës vlerësoi se nuk ka elemente për veprim kompetent sipas denoncimin në fjalë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Nënkryetar
Nuri Bajrami

Përgatiti: J.C.

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

